

Një furi e tillë e mirorkestruar debati opozitar dhe përpjekjesh analitike, kishte kohë pa u dëgjuar në këto anë. Jam përpjekur ditët e fundit, në fakt, ta ndjek sa kam pasur mundësi nëpër portale e studio dhe pastaj mundohesha të ndaja shapin nga sheqeri. Po ç'është kjo furi dhe çfarë kërkon të përfshijë me vete? Një projekt gjigant zhvillimor në brigjet e Durrësit.

Një sipërfaqeje toke prej 800 hektarësh, që shtrihet aty prej shekujsh dhe që ka qenë aty edhe përpara vitit 2013, po i tronditet kotësia dhe po i thuhet: “Dil në shesh të mejdanit dhe trego çfarë mund të bësh për shqiptarët e tu. Dil nga gjumi letargjik shekullor dhe sill jetë për këtë qytet. Dil e sill begati për këtë vend, që ka ngecur në vagonin e gabuar të vejetimit nga të mos bërit asgjë, në vagonin e pritjes dembele, se mbase ndonjë gjë bie nga qielli”. Një projekt gjigant po u thotë këtyre 800 hektarëve tokë ranore, të dalë nga agonia e të sjellë shpresën për këtë popull të lodhur nga vetë shpresa. Ky projekt gjigant po trondit themelet e fukarallëkut që ende e mban për fyti këtë vend të bekuar nga Zoti.

Ky projekt po trondit nga themelet të gjithë ata që kanë 30 vjet që po pijnë gjakun këtij populli, për të mbajtur gjallë pushtetin e kalbëzuar nga mosha. Ky projekt po trondit si uragan alibinë e kësaj opozite, se në këtë vend nuk vlen të jetohet, se ky vend nuk bëhet dot. Ky projekt pra, po i shkund te gjithë. Ai i ka zënë të gjithë në befasi me atë që propozon, i ka gjetur të papërgatitur, se çfarë do bëjnë me veten e tyre paskëtaj, fiks njësoj si ato vajtojcet që papritur kuptojnë se në vend ka veç të rinj dhe me gjasë do të mbeten pa punë. Kjo ishte një lëvizje shah-mat e qeverisë, ishte ndoshta asi nën mëngë i këtij mandati. Ndaj dhe reagimi është kaq gjithëpërfshirës, në çdo studio, në çdo ekran, në çdo portal, madje edhe atje ku nuk ta merrte mendja, te Panairi i Librit.

Po i marr me radhë:

1. “Do zhdukin portin mijëravjeçar” duan e thonë, edhe pse e dinë mirë se porti mbetet aty, po aq madhështor, por me destinacion tjetër. Porti shekullor do të zbukurohet nga dritat e qytetit dhe gëzimi i jetës, në vend që të ngriset nën vinçat dhe blozën e ngarkim-shkarkimeve, sepse Durrësi duhet t’i hapë vend mikpritjes së turistëve nga e gjithë bota, për t’i marrë botës pjesën e pasurisë që i takon, të cilën Zoti vetë ia ka caktuar në testament qysh kur e vendosi në ato brigje. Sa për portin e mallrave, ai tashmë ka filluar të zhvendoset 3-4 milje më tutje dhe do të ndërtohet më i madh dhe më modern atje ku vetëm

ndreq dhe nuk prish punë. Kjo ka kohë që po projektohet, duke ndjekur modelet e gjithë qyteteve turistike në botë.

2. “Qeveria po fal tokën”, duan e thonë dhe këtë e thonë pikërisht ata, që shpikën “Shqipëria 1 euro”, por që të vetmit blerës mbeten po vetë. Ata që falën gjithë industrinë e naftës nën tokë e mbi tokë, të gjitha pasuritë minerare nga Jugu në Veri, bakrin, kromin, çelikun, hidrocentralet, lumenjtë. Po kujt po ia fal tokën qeveria me këtë projekt, atë tokë që kurrkush nuk mundi ta jetësojë deri më sot? Kujt pra, po ia fal? Atyre që do të zgjedhin të jenë banorë të Durrësit, cilindo status të zgjedhin rezident, turist, investitor, për aq kohë sa kjo ndodh mbi Durrës dhe mbetet në Durrës.

3. “Po fiton më shumë arabi”, duan e thonë. Po ç’është ky koncept komunist? Po përse duhet vijë dikush të derdhë energji, dije, ide, kohë, qoftë edhe një qindarkë pasuri, pa pasur qëllimin universal të fitimit tregtar? Për filantropi? E kë ka nxjerrë në dritë filantropia? Filantropia është vdekje për një vend, se nuk mbjell asnjë farë që mbin e shtohet. Jep vetëm një pikë ujë në agoni dhe pastaj largohet, që mos të të shohë kur të japësh shpirt. Ndërsa investimi në një projekt biznesi e ka brenda farën, tokën dhe burimin e ujit për ta ushqyer derisa të bëhet pemë me kokrra. Nëse dikush dëshiron të kontribuojë për një vend, nuk jep ndihmë financiare, por mbështet politika që nxisin zhvillim.

4. “Është Alabbar, s’është Alabbar”, duan e thonë. Kushedi sa janë gajasur me qesëndi biznesmenët dhe pronarët e holdingëve që kuptojnë shqip, sepse kush është në biznes e di shumë mirë se ç’do të thotë të çelësh një shoqëri të re për një projekt të ri, është praktika më e zakonshme përmes të cilës çdo shoqëri dedikon dhe disiplinon energjitë e veta. Sipërmarrja është në radhë të parë ide dhe aftësi menaxhimi. Pa të kapitali është thjesht një sasi parash që mund të zhduket. Sipërmarrja është aftësia që ngre kapital dhe i jep atij arsye të angazhohet dhe të shtohet. Më thoni një projekt në botë, që nuk bëhet me instrumente borxhi, qoftë ai edhe i njeriut më të pasurit që ju njihni. Asnjë, sepse kjo është ADNja e sipërmarrësit dhe në këtë rast, sipërmarrja e ka emrin “Alabbar”, çfarëdo emri tregtar të ketë themeluar ai për idetë e veta, garancia është suksesi i tij, kudo ku e ka vendosur siglën e tij.

5. Të tjerat: pse aq për qind dhe jo kaq për qind? Pse të ngrohtë dhe pse të ftohtë? Pse sot dhe jo pasnesër? Janë të gjitha pyetje që shumë veta i kanë dhe secili prej nesh mund t’u japë përgjigje të ndryshme, në fakt, sepse ky quhet këndvështrim.

Po a mundet që modeli i zgjedhur i bashkëpunimit të ishte më i favorshëm për ne? E zëmë se po, por ama për ta zbuluar, do të duhej ai që quhet “debat konstruktiv” apo “propozim”. Po këto janë fjalë të panjohura për opozitën tonë, ndaj qeveria socialiste nuk do të djersijë ndonjëherë nga sikleti që ato do

të duhej t'i shkaktonin. Për fat të keq, duhet thënë. Meqë jemi te projekti i Durrësit dhe meqë kryefjala është Dubai, nuk mund të mos e shfrytëzoj këtë për të thënë sesa cekët noton opozita jonë. Merreni për shembull pozitiv Dubain, zotërinj, jo për konotacion negativ, sepse Dubai është bërë parajsë për banorët e vet. A dini si? Në vitin 2002 qeveria e Dubait theu barrierat fetare dhe ftoi të gjithë investitorët të investonin në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, pavarësisht përkatësisë fetare. Pikërisht këtu filloi bumi autentik.

Nëse mendoni se Dubai paskëtaj ka të bëjë vetëm me hotelet dhe bankat, e keni gabim. Ai është kthyer në fuqi turistike, tregtare, financiare, logjistike dhe industriale. Dhe Dubai për rastësi ka vetëm 3 milionë banorë, dhe në themel të ideimit të tij, jo për rastësi, është pikërisht sigla e suksesshme "Alabbar". Unë sot lutem që ky projekt t'ia dalë mbanë, të vihet në jetë më shpejt sesa është parashikuar në marrëveshje. Sido që të jetë kompozimi i tij, në apartamente, hotele, njësi biznesi, shëtitore dhe qershia mbi tortë, marina jahtesh apo marinë detare, një gjë do ta bëjë me siguri, ai do të asamblojë në një të vetme një nyjë zhvillimi, ku do të takohen të gjitha arteriet e ekonomisë shqiptare dhe paskëtaj asgjë nuk do të jetë më si më parë. Një korsi e re po i hapet të ardhmes së Shqipërisë. Faleminderit!